# DËSHMI ARKIVI

**A-458552**
VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Superiore - Dinamo nuk ndalet, mposht Laçin dhe feston fitoren e katërt radhazi |
| ADRESA | `https://www.syri.net/sport/917900/dinamo-nuk-ndalet-mposht-lacin-dhe-feston-fitoren-e-katert-radhazi/` |
| BURIMI | syri.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 19 shtator 2026, 18:40:13 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 19 shtator 2026, 18:34:38 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `b25c0de2aa352139b53e3018c379b8d72118950a830051b9e5a260c7d7619d36` |
| TEKSTI | `81f8d9f939bc1b8100ff5d7fd392eb3aff0be96c5a59c2794cd63af99c29ce77` |
| PAMJA | `de9350ff83addbf9c5628d78d7694e672ad6373d69b317c9f1f5eeb6ed3d9e77` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `b4d23c1fbba66703689d8099d1928f41d36fcf037ee02e2915ab89db54fa473e` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `12839dc4b023db7c55325e9d2ee92462b471b26279290faf1035fe327d267353` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/b4d23c1fbba66703689d8099d1928f41d36fcf037ee02e2915ab89db54fa473e`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



**ENVER ROBELLI**

Qëndrimi i Zagrebit dhe heshtja e Tiranës



**NDRIÇIM KULLA**

Rama dhe Vuçiç, dy vëllezërit siamezë të dekadencës demokratike evropiane

**LAJMI I FUNDIT**

LVIE - Protesta sot në ditën e 112-të, Rama jep dorëheqjen!



# Dinamo nuk ndalet, mposht Laçin dhe feston fitoren e katërt radhazi

20:34, 19/09/2026

Dinamo vazhdon marshimin në Kategorinë Superiore. Blutë kanë regjistruar fitoren e katërt radhazi në kampionat, duke mposhtur Laçin me rezultatin 3-1 në "Elbasan Arena", në një ndeshje të luftuar dhe me disa momente të diskutueshme.

Dinamo e gjeti golin e avantazhit në minutën e 22-të. Lorran u shkëput në krahun e majtë, hyri në zonë dhe goditi menjëherë, duke përfituar edhe nga pasiguria e portierit Guri për të dërguar topin në rrjetë.

Avantazhi i bluve zgjati vetëm tri minuta. Laçi reagoi menjëherë dhe barazoi në minutën e 25-të me Gamarra, i cili goditi nga jashtë zonës dhe mposhti Teqjen.

Në fundin e pjesës së parë, Laçi mbeti me 10 lojtarë. Në minutën e 42-të, Gamarra u ndëshkua fillimisht me karton të verdhë për një faull ndaj Berishës, por pas ndërhyrjes së VAR-it, gjyqtari e ndryshoi vendimin dhe e ndëshkoi me karton të kuq, pasi e cilësoi lojtarin e fundit.

Në pjesën e dytë, Dinamo shfrytëzoi epërsinë numerike dhe kaloi sërish në avantazh në minutën e 55-të. Një top i devijuar në qendër përfundoi tek Vila, i cili nuk gaboi përballë Gurit dhe shënoi për 2-1.

Laçi tentoi të reagonte dhe në minutën e 86-të ishte shumë pranë barazimit, por goditja e Azizi nga një goditje dënimi u ndal në shtyllë.

Në fund, Dinamo vulosi fitoren. Në minutën e 92-të, Ferruku shërbeu për Ruçin, i cili realizoi me një goditje diagonale për 3-1. Laçi protestoi për një faull në fillim të aksionit, por goli u konfirmua.

## më të lexuarat

Julian Alvarez rikuperohet në kohë, gati për derbin ndaj Real Madridit

'Dua Real Madridin në Champions'/ Intervista e Yamal: Si e bërtitura e Busquets më ndryshoi jetën

VIDEO/ Gol i pazakontë nga Mesi, argjentinasi fiton trofeun e radhës kundër meksikanëve

Eric Garcia zgjedh favorit për 'Topin e Artë': E meriton Lamine Yamal

Zyrtare: Chelsea ndryshon pronësinë, Todd Boehly largohet nga klubi

Benfika e mposhti Milanin me 'rezervat', Amorim në alarm: Nuk jam në gjendjen e duhur mendore

Kështu, Dinamo merr tri pikët e radhës dhe regjistron fitoren e katërt radhazi në kampionat.

| # | TEAM | MP | W | D | L | G | GD | PTS | FORM |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Teuta | 5 | 4 | 1 | 0 | 10:2 | 8 | 13 | ? W W W W D |
| 2. | Dinamo City | 5 | 4 | 0 | 1 | 10:5 | 5 | 12 | ? W W W W L |
| 3. | Egnatia | 4 | 3 | 0 | 1 | 9:4 | 5 | 9 | ? L W W W |
| 4. | Laci | 5 | 2 | 1 | 2 | 7:8 | -1 | 7 | ? L W L W D |
| 5. | AF Elbasani | 4 | 1 | 2 | 1 | 5:5 | 0 | 5 | ? W L D D |
| 6. | KF Tirana | 4 | 1 | 1 | 2 | 6:7 | -1 | 4 | ? D W L L |
| 7. | Partizani | 4 | 1 | 1 | 2 | 6:8 | -2 | 4 | ? L W L D |
| 8. | Vora | 5 | 1 | 1 | 3 | 3:10 | -7 | 4 | ? D L L L W |
| 9. | Skenderbeu | 5 | 0 | 3 | 2 | 5:7 | -2 | 3 | ? D D L L D |
| 10. | Vllaznia | 5 | 0 | 2 | 3 | 5:10 | -5 | 2 | ? L L L D D |

© SYRI.net

Lexo edhe:


VIDEO/ Salah i bëhet makth Galatasaray-t, shënon dygolësh dhe feston me Muçin


Juventusi merr një goditje të rëndë, portieri dëmton ligamentin e kryqëzuar


Ahmataj analizon barazimin me Vorën: Terreni ndikoi, nuk bëmë ndeshjen tonë

Bëje LIKE dhe merr lajmin e fundit nga Sporti:

## Komentet

Shto koment

Emri

Shkruani komentin tuaj

Posto

Harry Kane dhe 'Topi i Artë': S'më pëlqen të flas për veten, 73 golat në sezon flasin vetë!

Arbër Hoxha largohet nga Dinamo Zagrebit, transferohet në Emiratet e Bashkuara Arabe

Messi do t'i japë lamtumirën Argjentinës në ndeshjen e 6 tetorit kundër Beninit

TË NGJASHME

Frankfurti dhe Freiburgu dhurojnë spektakël, por jo fitues, Bayerni i vetëm në krye

VIDEO/ Dygolëshi i Lautaros shpëton Interin nga humbja në 'Olimpico'

Brightoni turpëron Arsenalin, kampionët pësojnë tre gola

Skënderbeu i mohon fitoren Vorës me ndihmën e VAR-it, polemika në fund

Palladino e nis me barazim te Bologna, Cagliari vazhdon marshimin

Një 22-vjeçare shkruan historinë, gruaja e parë që drejton një ekip meshkujsh në Turqi

Nga Seria D në elitën skoceze, njihuni me prurjen e re në Kombëtare, Sabah Kerjota

SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.